



Në mbështetje të nenit 4 lidhur me nenin 13 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, neni 5 lidhur me nenin 12 dhe 22 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017, për destinimin e mjeteve nga fondi për transfer dhe subvencione, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Rahovecit, hap këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural përmes kësaj shkrese ju bën thirrje publike për aplikim të gjitha OJQ-ve, të regjistruara në Republikën e Kosovës që vepronë brenda territorit të Komunës së Rahovecit dhe që kanë përvojë në organizimin e festivaleve, të aplikojnë për organizimin e festave tradicionale kulturore në Komunën e Rahovecit, të cilat janë:

1. Festa e vjeljes së rrushit 7 shtatori – Hardhi'fest - Rahovec
2. Agrofesta – Krushë e Madhe

Qëllimi

Qëllimi i kësaj thirrjeje publike është subvencionimi dhe mbështetja financiare për OJQ-të, të cilat vepronë në Komunën e Rahovecit dhe të cilat kanë përvojë në organizimin e eventeve dhe festivaleve, të cilat kanë për qëllim promovimin e kulturës, trashëgimisë si dhe promovimin e produkteve bujqësore:

1. Festa e vjeljes së rrushit në kuadër të së cilës bëjnë pjesë:

- Promovimi i hardhisë së rrushit,
- Promovimi i prodhimeve të rrushit,
- Promovimi i kulturës dhe artit të Komunës së Rahovecit,
- Organizimi i ngjarjeve me karakter bashkëpunimi për promovimin e vlerave kulturore,
- Aktivitetet tradicionale kulturore,
- Promovimi i vlerave artizanale të Komunës së Rahovecit
- Promovimi dhe ruajtja e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe historike,

2. Agrofesta në kuadër të cilës bëjnë pjesë:

- Promovimi i kulturave bujqësore
- Promovimi i produkteve të ndryshme të përpunuara si p.sh turshive, ajvarit, reqelname dhe pegmezit
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme
- Promovimi i vlerave artizanale

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 80,000 Euro

Specifikat tjera të thirrjes publike

- Thirrja publike për aplikim hapet më 18.06.2026 dhe mbyllet më 02.07.2026
- Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së afatit për aplikim nuk do të pranohen.
- Aplikacionet e pa kompletuara sipas kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje do të refuzohen.
- Zbatimi i projekteve do të monitorohet nga personi përgjegjës i përcaktuar nga DBPZHR.
- Mbështetësi financiar, përkatësisht Komuna e Rahovecit dhe përfituesi i donacionit do të lidhin kontratë me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.
- Me secilën OJQ që do të jetë përfituese e subvencionit do të nënshkruhet kontratë të mjeteve financiare dhe mbështetësit financiar.

Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e subvencionit

- Projekt-propozimi, përfshirë, agjendën, aktivitetet, planifikimi dhe linja buxhetore në harmoni me qëllimin e projektit,
- Kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar nga OJQ,
- Certifikata me numër fiskal,
- Certifikata me numër të regjistrimit të biznesit,
- Vërtetimi i llogarive bankare në emrin e OJQ-së dhe kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar,
- Raporti financiar i vitit paraprak,
- Vërtetimi nga ATK për shlyerje të obligimeve (OJQ-të me pasqyra financiare të audituara do të kenë përparësi)
- Dëshmia se ka përvojë në realizimin e projekteve duke siguruar dëshmi të realizimit të projekteve të ngjashme në të kaluarën.

Mënyra e aplikimit

- Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zarf të mbyllur,
- Brenda zarfit vendosen një kopje e të gjitha dokumentacionit origjinal të kërkuara,
- Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e pranimit në katin e parë në objektin e Komunës.

